

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Njësia org. Org. Unit	Nr. i Prot. Prot. No.
01	7415
Nr. i Faqe Br. Stranica No. Pages	Data: Datum: Date
02+slt	11.07.19
PRISHTINË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
KM-MIT	486/19
2+slt	Data: Datum: Date
	11.07.19
TINË/A	

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr. 26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ 06/2016 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr.5517 të dt.23.05.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet nr. prot. 4984 të dt. 13.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.T. "Pranvera" nga Peja, ndaj vendimit nr.4142 të dt.19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Istog – Klinë - Prishtinë, për nisjen 05:30 me kthim 07:30, nisjen 09:00 me kthim 11:10, nisjen 17:30 me kthim 19:35.

Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës: 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4984 të dt. 13.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.T. "Pranvera" nga Peja, ndaj vendimit nr.4142 të dt.19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Istog – Klinë - Prishtinë, për: nisjen 05:30 me kthim 07:30, nisjen 09:00 me kthim 11:10, nisjen 17:30 me kthim 19:35 dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbalit të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, ka konstatuar se komisioni i caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit nr.prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 me procesverbalin nr.2145 të dt.12.03.2019 ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit dhe se operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (3) të shpalljes publike nr.1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.7 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosje të aplikimit ka prezantuar 6 (gjashtë) autobus të certifikuar ndërsa sipas evidencës në DTT të konstatuar nga komisioni sipas vendimin nr.

nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit i njëjti posedon 7 (shtatë) rende të udhëtimit në transportin ndër urban dhe 2 (dy) leje në transportin ndërkombëtar.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroi pari në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI –së.

